



**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 10, datë 14.10.2020

PËR

**MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA CËRRIK, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 11, DATË 08.02.2017,
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT**

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 11, datë 08.02.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Cërrik”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Cërrik, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Cërrik Nr. 93, datë 12.10.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Cërrik”, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Cërrik, të miratuar me Vendimin Nr. 11, datë 08.02.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e:
 - *Rregullores së Planit:*
 - o *shtesa dhe ndryshime të neneve;*
 - o *seksioni “Tabela e treguesve të njësive në Rregullore”,**sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Cërrik, bashkëlidhur këtij Vendimi.*
2. Ngarkohen Bashkia Cërrik dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Cërrik, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

REPUBLIKA E SHQËRIE
MINISTRI E SHQËRIE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MINISTËR I LINJËS

BELINDA BALLUKU



MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

